



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,  
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202000068/2

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2020

**Lënda:** *Rekomandime për inspektimin e bërë në ambientet e Komisarariatit të Policisë Nr.6, Tiranë.*

**Drejtuar :** **Z. Ardit ELMAZI**  
Shef i Komisarariatit të Policisë Nr.6

**TIRANË**

**Për djeni:, Drejtues i Parë Rebani JAUPI**  
*Drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë*

**TIRANË**

*I nderuar z. Elmazi,*

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar<sup>1</sup>, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, kreu një inspektim në Komisariatin e Policisë Nr.6 Tiranë.

Inspektimi u krye në datën 23.12.2019, sipas Planit të Inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z. Besnik Deda dhe znj. Nertila Qafzezi, me detyrë Nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014, "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde "Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre", Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.306, datë 31.03.2016, për miratimin e procedurës standarde "Rregullat teknike të shoqërimit në polici", si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimit të mëparshëm.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit të inspektimit dhe verifikoi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i mëparshëm, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtrojë konkluzionet përfundimtare, duke ju referuar si më poshtë vijon:

<sup>1</sup> Neni 74/1 i ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", i ndryshuar.

## Shënime të përgjithshme

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas të privuar nga liria, grupi i inspektimit, në mungesë të Shefit të Komisarariatit dhe shefit të sektorit të rendit, u takua me përgjegjësën e zyrës të informacionit të këtij komisaritati, i cili u vu në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Më tej, punonjësi i zyrës së informacionit shoqëroi grupin e inspektimit gjatë verifikimit të kushteve në ambientin e shoqërimit, intervistave që zhvilloi me personat e shoqëruar në mjediset e policisë, si dhe vuri në dispozicion dokumentacionin dhe regjistrin ku pasqyrohen veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar apo ndaluar, sipas kërkesave të përcaktuara në procedurën standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”.

Grupi i inspektimit, verifikoi gjithashtu zbatimin e rekomandimeve të bëra nga Institucioni i Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm, nga i cili rezultoi se, **kalimi dhe vënia në funksion e godinës së re të Komisarariatit të Policisë nr.6, kishte krijuar kushte dhe standarde cilësore për trajtimin dhe qëndrimin e personave të shoqëruar në mjediset e policisë.**

Theksojmë se, punonjësit e policisë së këtij komisaritati u treguan bashkëpunues dhe transparentë gjatë komunikimit dhe inspektimit të kryer.

Grupi i inspektimit të Avokati i Popullit në përfundim, konstatoi problematika në lidhje me kushtet dhe respektimin e të drejtave të personave që shoqërohen në mjediset e policisë të Komisarariatit të Policisë nr.6, duke ju referuar si më poshtë vijon:

### Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre

Në Komisariatin e Policisë nr.6 Tiranë, ambienti i shoqërimit ishte i ndërtuara sipas kërkesave të përcaktuara në ligjin nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe sipas procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.306, datë 31.03.2016.

Mjediset e ambientit të shoqërimit ndodheshin në katin e parë të godinës së komisarariatit dhe përbëhen nga 3(tre) dhoma shoqërimi me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim të personave të shoqëruar, si dhe të ndara më vete për femra, meshkuj madhorë dhe të mitur.<sup>2</sup>

Dritaret e dhomave ishin me përmasa të tilla që lejojnë mundësinë e ajrimit dhe ndriçimit të plotë natyral. Në pjesën e jashtme, dritaret ishin të siguruara me skarë të hollë hekuri, me qëllim parandalimin e largimit apo arratisjes së personave të shoqëruar nga këto mjedise. Cdo dhomë kishte dhe ndriçim artificial që furnizohej nga rrjeti elektrik.

Nga inspektimi rezultoi se, në dhomat e shoqërimit **mungonin** orenditë e nevojshme si tavolina e karrige për qëndrimin ulur të personave të shoqëruar. Personat që ndodheshin

---

<sup>2</sup> *Kreu VI, pika 3 e procedurave standardeve “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”*

në dhoma gjatë kohës së inspektimit, deklaruan se kishin nga 1 deri në 7 orë që qëndronin në këmbë ose ulur në tokë në dysheme, pa asnjë shtroje. Kjo përbën trajtim jo human dhe degradues, si dhe shkelje të të drejtave të personave të shoqëruar, të cilat janë të garantuara me aktet ligjore dhe nënligjore.

Brenda këtij ambienti ndodheshin gjithashtu 2(dy) dhoma për intervistimin/marrjen në pyetje të personave të rritur dhe 1(një) dhomë për intervistimin e personave të mitur, të cilat ishin me kushte të përshtatshme dhe të pajisura me tavolina pune për punonjësit e policisë dhe karrige për qëndrimin ulur të këtyre personave. Dhoma për intervistimin e të miturit ishte e pajisur me orendi e pajisje të reja, postera figurativ dhe karta me të drejtat që gëzojnë të miturit kur shoqërohen në këto mjedise, duke krijuar një ambient miqësor. Gjithashtu, ato ishin me hapësirë dhe sipërfaqe të bollshme, si dhe me dritare për ajrim dhe ndriçim natyral.

Ngjitur me dhomat e shoqërimit ndodheshin 2(dy) tualete, të ndara më vete për meshkuj dhe femra, të cilat kishin furnizim me ujë të rrjedhshëm.

Mjedisi dhe ambientet e dhomave të shoqërimit, në tërësi ishin të pastra nga ana higjieno-sanitare, por kishin nevojë për lyerje, pavarësisht se godina e komisarariatit ishte e re.

Mjedisi i shoqërimit, dhomat ku mbaheshin dhe qëndronin të shoqëruarit, si dhe dhomat e intervistimit, monitoroheshin me sistemin audio-viziv të kamerave dhe mbaheshin nën vëzhgim nga punonjësit e zyrës të informacionit të komisarariatit.

Në të gjitha mjediset dhe në dhomat e shoqërimit, grupi i inspektimit nuk gjeti sende apo mjete të tilla që mund të shërbejnë për kryerjen e vetëvrasjeve të të shoqëruarve apo për kundërveprim ndaj punonjësit të policisë.

Nga informacioni i marrë në intervistat konfidenciale me personat e shoqëruar, u konstatua se në këtë komisarariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

U evidentuan disa praktika të konkrete ku në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë në Komisarariatit e Policisë nr.6 Tiranë, mbaheshin procesverbalet përkatëse ku njëra prej kopjeve firmosej dhe i jepej personit të shoqëruar.

Nga intervistimi i personave të shoqëruar që ndodheshin në kohën e inspektimit, rezultoi se, ata nuk ishin njohur me të drejtat që gëzojnë gjatë kohës të qëndrimit në këto mjedise, si dhe nuk kishin kopje të kartës me të drejtat e tyre.

### **Ambientet e sigurisë/kushtet e tyre**

Në Komisarariatit e Policisë nr.6, Tiranë, nuk kishte ambiente sigurie, ndaj personat e arrestuar/ndaluar pas kryerjes së procedurave me oficerët e policisë gjyqësore, dërgoheshin menjëherë në ambientet e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë.

## **Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar dhe evidentimi i tyre**

Në zbatim të ligjit Nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr.306, datë 31.03.2016, për miratimin e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, zyra e informacionit të këtij komisariati ishte e pajisur me dokumentacionit dhe regjistrat përkatës.

Gjatë inspektimit u konstatua se, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr. 1” konform me procedurat standarde dhe ishte i sekretuar. Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit.

*Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se:*

Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi e shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë<sup>3</sup>.

Në këtë komisariat ishte vendosur dhe regjistri për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë.

Ndërkohë u konstatua se në këtë komisariat kishte edhe regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por nuk ishte evidentuar asnjë kërkesë apo ankesë për vitin 2019.

### **Ambientet e intervistimit**

Në Komisarlatin e Policisë Nr.6 Tiranë, oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet proceduriale me shtetasit në dhomat e intervistimit të dedikuara për personat e rritur dhe për personat e mitur, që ndodheshin në ambientin e shoqërimit.

Këto zyra ishin të monitoruara me sistemin audio-viziv me kamera dhe ishin të pajisura me orenditë e nevojshme si tavolina pune për punonjësit e policisë dhe karrige për qëndrimin ulur të personave, të cilat ishin të fiksuara në dysheme.

Nga monitorimi që iu bë zyrave të punonjësve të policisë dhe dhomave të intervistimit, në këtë komisariat, nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime proceduriale.

---

<sup>3</sup> *Kreu VII, Procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrit Nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit*

## **Ndihma juridike, psikologjike dhe kujdesi mjekësor**

Në këtë Komisarlatin e Policisë nr.6, zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Nga pyetja e punonjësve të policisë u referua se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë të cilët nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej mbrojtja me avokat.

Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht, kujdestarit ligjor dhe të psikologut që ofrohej menjëherë nga DVP Tiranë.

Në kohën e inspektimit, në dhomën e shoqërimit ndodheshin 3(tre) persona të shoqëruar. Grupi i inspektimit intervistoi këta persona dhe nga deklaratimet e tyre rezultoi se, punonjësit e policisë që kishin kryer shoqërimin e personave për në mjediset e policisë, ishin prezantuar me identitetin e tyre dhe nuk kishin ushtruar dhunë apo keqtrajtime fizike e psikologjike. Nga komunikimi me të shoqëruarit rezultoi gjithashtu se, ishin njoftuar pjestarët e familjeve të tyre, si dhe nuk kishin nevojë për avokatë mbrojtës.

Gjatë inspektimit u konstatua se në korridoret e godinës dhe mjedisin e shoqërimit të këtij komisarlati, ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe të personave të ndaluar/arrestuar.

Për sa më sipër dhe me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”* dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454 dt.04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,

### **REKOMANDOJMË :**

1. Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e dhomave të shoqërimit në Komisarlatin e Policisë nr.6, Tiranë me karrige ose stola për qëndrimin ulur të personave të shoqëruar, sikurse përcaktohet në procedurën standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”.
2. Marrjen e masave të menjëhershme për lyerjen e ambienteve të shoqërimit, duke krijuar kushte të përshtatshme dhe dinjitoze për personat që qëndrojnë në këto mjedise.
3. Marrjen e masave të menjëhershme, për trajnimin e oficerëve të policisë gjyqësore dhe punonjësit e policisë në zyrën e informacionit, që gjatë plotësimit të dokumentacionit (urdhër për ndalim/arrestimi të personave, proces verbale dhe regjistër) të personave të shoqëruar, të evidentojnë saktësisht orën kur ata janë të shoqëruar për në mjediset e

policisë, si dhe për kalimin e tyre në dhomat e sigurisë të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë.

Për qëndrimin dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**KOMISIONER**

**Ermonela XHAFA**